



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .03.2024

**MBLEDHJA Nr. 9,  
Datë 02.04.2024, ora 13:00  
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 02.04.2024, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 9 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2024 për shoqëritë ujësjellës kanalizime, të cilat furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2024.
3. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin shkurt 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
4. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve “Furra buke dhe/ose prodhim mielli”.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 287, datë 09.10.2023.
6. Mbi kërkesën e OST sh.a., për intervalin kohor 1 orë në operimin e proceseve të tregut balancues dhe nominimeve të transaksioneve tregtare.
7. Mbi lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltai në digën e Qyrsaqit, Hec “Vau i Dejës”, i shoqërisë “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a. KESH)”.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
9. Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin nr. 240, datë 03.08.2023 dhe refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. për transferimin e pjesshëm të licencës për

prodhimin e energjisë elektrike, për Hec-in Zalli i Bulqizës, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.

10. Mbi kërkesën e shoqërisë “Truen” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “Hydroborsh” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj.
12. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.253, datë 23.08.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 20MW (AC).
13. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.303, datë 23.10.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1”.
14. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Alb gaz sh.a.”, i ndryshuar.
15. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.97, datë 09.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me vendndodhje në zonën e Remasit-Karavasta,Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140MWp.
16. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARE NË DETYRË**  
**Erjola SADUSHI**